

## Mbetje të rënda

Të gjitha mbeturinat, që për shkak të madhësisë dhe/ose peshës, nuk mund të hidhen në koshat e mbeturinave të tjera, mund të klasifikohen si mbeturina të rënda.

Për shembull: tavolina, dollapi, karriget, divanet, tapetet, karrocet e fëmijëve, dyshekët, krevatet me pupla, tharëset e rrobave, biçikletat, lodra të rënda, etj.

Të gjitha **pajisjet elektrike** trajtohen ndaraz nga mbetjet e shtëpisë dhe ato të rënda.

**Kujdes:** Nuk klasifikohen si mbetje të rënda, materialet e ndërtimit dhe ato hidraulike, si dërrasat, trarët, panelet, kornizat e dritareve, dyert, gardhet, vaskat, lavamanët, tualetet ose shkarkuesit e tualeteve, kaloriferët, shtresat e dyshemeve, grilat, si dhe pjesët e makinave, motoçikletat, makinat kositëse që punojnë me benzinë, mbetjet e rikonstruktiveve, mbetje të kopshteve, qeset e plehrave ose kartona me mbetjet e shtëpisë.

**Objektet që nuk mund të ngrihen nga dy persona (më të rëndë se 50 kg secili), nuk klasifikohen tek mbeturinat e rënda**